



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS RAHOVEC

Numri i lëndës: 2022:284589

Datë: 24.02.2025

Numri i dokumentit: 06890457

CN.nr.99/2022

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË – DEGA NË RAHOVEC, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, gjyqtari Avni Berisha, me bashkëpunëtoren profesionale Shpresa Haxhijaha Rahmani, në çështjen jokontestimore të propozuesit S.R.Sh nga Rahoveci, të cilin me autorizim e përfaqëson avokat B.O nga Rahoveci, kundër kundërpropozuesve E.U, R.U, S.U, M.D, N.V, R.V, dhe P.V, që të gjithë nga Rahoveci, lidhur me çështjen jo kontestimore propozim për rregullimin dhe caktimin e mëgjeve në marrëveshje me kundërpropozuesit, më datë 24.02.2025 mori këtë:

A K T V E N D I M

- I. KONSIDEROHET SË ËSHTË TËRHEQUR propozimi i propozuesit S.R.Sh nga Rahoveci, kundër kundërpropozuesve E.U, R.U, S.U, M.D, N.V, R.V, dhe P.V, që të gjithë nga Rahoveci, lidhur me propozimin për rregullimin dhe caktimin e mëgjeve në marrëveshje me kundërpropozuesit.

- II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Propozuesi S.R.Sh nga Rahoveci, përmes përfaqësuesit të tij të autorizuar, me datë 29.12.2022 ka paraqitur në Gjykatë propozim për rregullimin dhe caktimin e mëgjeve në marrëveshje me kundërpropozuesit.

Gjykata duke vepruar lidhur me këtë çështje, me datë 06.01.2025 ka mbajtur seancën përgatitore, meqenëse nuk janë plotësuar kushtet për mbajtjen e seancës gjykata ka marrë Aktvendim me të

cilin propozuesit S.R.Sh, i kthehet propozimi në plotësim dhe përmirësim, që në afat prej 3 ditëve ta sigurojë adresën e kundërpropozuesit P.Vnga Rahoveci.

Në shkresat e lëndës deri më tani gjykata nuk pranuar ndonjë shkresë nga propozuesi për plotësim të propozimit.

Duke marrë parasysh faktin se as pas aktvendimit të ndërmarrë nga gjykata, propozuesi nuk e ka bërë përmasimin dhe plotësimin e propozimit, gjykata vendosi si në dispozitiv, e në pajtim me dispozitat e nenit 99.2, 99.3 dhe 102.3 të Ligjit nr.03/1-006 për Procedurën Kontestimore, në të cilin nen thuhet se: 102.3 *“Do të konsiderohet se është tërhequr parashtresa po që se nuk i kthehet gjykatës brenda afatit të caktuar, e në qoftë se i kthehet pa u korrigjuar, gjegjësisht pa u plotësuar, parashtresa do të hidhet poshtë.”*

Vendimi mbi shpenzimet procedurale, që secila palë t’i bartë këto shpenzime, është marrë në kuptim të nenit 450 të LPK-së.

Prandaj, nga ajo që u tha më lartë, kjo gjykatë vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi, e në bazë të nenit 99.2, 99.3 dhe 102.3 të LPK-së.

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË – DEGA NË RAHOVEC

Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil

CN.nr.99/2022, më datën 24.02.2025

Gjyqtari
Avni Berisha

KËSHILLË JURDIKE: Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa, në afat prej 15 ditësh, nga dita e marrjes së të njëjtit, përmes kësaj Gjykate, për Gjykatën e Apelit.